



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E DREJTËSISË  
Drejtoria e Financës

Nr. 3333 / Prot.

Tiranë, më 30.05. 2017

**Lënda:** Dërgohen raportet e monitorimit 4-mujor për vitin 2017

**Drejtuar:** **MINISTRISË SË FINANCAVE**  
**Drejtoria e Monitorimit dhe Zbatimit të Buxhetit**


**TIRANË**

Në zbatim të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, ligjit Nr.147/2015, Udhëzimit plotësues Nr.8, datë 13.01.2017 “Për zbatimin e Buxhetit të vitit 2017”, si edhe Udhëzimit të Ministrisë së Financave, Nr. 2, datë 6.02.2012 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar, pika 256, ju dërgojmë raportet e monitorimit 4-mujor të buxhetit për vitin 2017, duke analizuar performancën financiare dhe realizimin e produkteve dhe objektivave, sipas programeve.

Ministria e Drejtësisë ka administruar dhe menaxhuar fondet buxhetore për tetë programe konkretisht:

1. *Planifikim, Menaxhim dhe Administrim*
2. *Qendra e Botimeve Zyrtare*
3. *Instituti i Mjekësisë Ligjore*
4. *Sistemi i Burgjeve*
5. *Shërbimi i Përmbarimit Gjyqësor*
6. *Komiteti Shqiptar i Birësimit*
7. *Agjencia e Kthimit dhe Kompesimit të Pronave*
8. *Shërbimi i Provës*

## Buxheti i Ministrisë së Drejtësisë sipas Institucioneve



Fondet buxhetore për 4 mujorin e parë per vitin 2017, për të gjithë Sistemin e Ministrisë së Drejtësisë, janë realizuar në **masën 84%**, siç shihet edhe në tabelën e mëposhtme:

Ne 000/leke

Nr	Emri i programit	Buxheti i akorduar në fillim të vitit 2017	Buxheti për vitin 2017	Fakti për vitin 2017	
				Në lekë	Në % ndaj planit
1	Planifikim Menaxhim Administrim	767,500	767,500	290,609	99%
2	Qendra e Botimeve Zyrtare	49,400	83,000	11,894	46%
3	Instituti i Mjeksisë Ligjore	136,500	136,500	25,272	85%
4	Sistemi i Burgjeve	4,958,000	5,007,800	1,414,668	75%
5	Shërbimi i Përmbartimit Gjyqësor	135,000.0	135,000.0	30,190.0	54%
6	Shërbimi për Çështjet e Birësimeve	13,800.0	13,800.0	2,998.6	52%
7	Shërbimi i Kthimit e Kompesimit të Pronave	2,079,500	2,079,500	1,244,209	96%
8	Shërbimi i Provës	181,000	181,000	37,752	62%
	<b>Totali</b>	<b>8,320,700</b>	<b>8,404,100</b>	<b>3,057,593</b>	<b>84%</b>

Ndërsa, realizimi i shpenzimeve për fondet me financim të huaj, është si më poshtë: ne 000/leke

Nr	Emri i programit	Buxheti i akorduar në fillim të vitit 2016	Buxheti përfundimtar i vitit 2016	Fakti i vitit 2016	
				Në 000 leke	Në % ndaj planit
1	Sistemi Burgjeve				
	<b>Totali</b>				

Këto shifra janë në nivele të mira. Të gjithë strukturat vartëse të Ministrisë së Drejtësisë, kanë punuar për të plotësuar objektivat e parashikuara në programet e tyre si edhe për të realizuar produktet e përfituara, duke përdorur me efikasitet dhe efektivitet fondet buxhetore të akorduara për çdo program dhe për çdo zë shpenzimesh.

Një analizë më të hollësishme të realizimit të shpenzimeve dhe produkteve, për 8 programet e Ministrisë së Drejtësisë, e sjellim më poshtë:

## Monitorimi i Shpenzimeve dhe Produkteve sipas programeve.

### 1. Programi “Planifikim, Menaxhim, Administrim”.

Ky program përfshin 5 institucione:

1. Aparatin e Ministrisë
2. Avokaturën e Shtetit
3. Komisionin Shtetëror për Ndihmën Juridike
4. Agjensinë për Mbikqyrjen e Falimentit.
5. Arkivi Gjyqësor

Realizimi për këtë program, duke e krahasuar me planifikimin e periudhës, sipas zërave kryesorë, rezulton si më poshtë:

• Shpenzimet e personelit	76 %
• Shpenzimet e tjera operative	68 %
• Shpenzimet kapitale	81 %
<b>Gjithsej</b>	<b>74 %</b>

Për kryerjen e veprimtarisë kryesore dhe përbushjen e objektivave të përcaktuara, për 4-mujorin e vitit 2017 Programi Planifikim, Menaxhim, Administrim, ka parashikuar 9 produkte, nga të cilat për këtë periudhë janë realizuar plotësisht 8 (disa prej tyre edhe tejkaluar). Kështu, u realizuan plotësisht sipas parashikimit të periudhës, produktet, “Inspektime në Prokurori, inspektime në Gjyqësor, Administrativ dhe në Pronësi”, nga 28 inspektime të parashikuara, u realizuan 28 inspektime, vlen për tu theksuar për inspektimet në institucionet vartëse dhe në profesionet e lira, se janë kryer inspektime me shtrirje në zyra përmbarimore, noterie dhe institucionet e varësisë. Inspektimet në Prokurori dhe në Gjyqësor janë kryer dhe në bazë ankese përveç atyre të parashikuara nga Drejtoria e Inspektimit të Prokurorisë dhe Gjyqësorit. Në kuadër të produktit “Akte ligjore e nënligjore të hartuara”, janë përgatitur 5 akte ligjore e nënligjore, nga 5 të parashikuara.

Produkti “Asistencë Juridike Institucione Shtetërore dhe Enteve Publike Nëpërmjet këshillimit dhe përfaqësimit në gjykatat Ndërkombëtare” është realizuar në terma sasiorë, nga 1240 raste të parashikuara për përfaqësim të avokatëve të shtetit në çështjet gjyqësore janë realizuar 1200 , si edhe është dhënë “asistencë juridike dhe këshillim” nga avokatët e shtetit.

“Ndihmë juridike për individët përfitues” është realizuar në terma sasiorë produkti, nga Komisioni i Ndihmës Juridike. Është parashikuar ofrimi i ndihmës juridike, këshillimit dhe mbrojtjes në proceset penale për 217 raste për 4-mujorin e vitit 2017 dhe janë realizuar 217 raste.

Për Agjensinë e Mbikqyrjes së Falimentit ka parashikuar dy produkte “Licensimi i Administratorëve të Falimentit” për periudhën, nga veprimtaria e këtij institucioni janë planifikuar të licensohen 5 administratorë dhe janë kryer po aq si dhe janë mbikqyrur 17 administratorë të falimentit nga 30 të planifikuar.

## 2. Programi “Qendra e Botimeve Zyrtare”

Realizimi i shpenzimeve të vitit 2016 për këtë program, i krahasuar me planin e periudhës, është në **masën 46 %**, ose sipas zërave kryesorë:

• Shpenzimet e personelit	93%
• Shpenzimet e tjera operative	25%
• Shpenzimet kapitale	0%
<b>Gjithsej</b>	<b>46%</b>

Siç shihet, realizimi i shpenzimeve të programit është në shifra normale.

Për 4-mujorin e vitit 2017 janë parashikuar 4 produkte të programit, “Publikimi i fletores zyrtare”, “Botime Kode dhe Përmbledhese Legjislacioni”, “Botimi i Buletinit të Njoftimeve Zyrtare”, dhe “Publikimi në Internet”. Produkti i parë “Publikimi i fletores zyrtare” është tejkaluar nga 91 fletore zyrtare të planifikuara janë realizuar 110 kurse produkti i dytë “Botime Kode dhe Përmbledhese Legjislacioni” janë planifikuar 1 dhe realizuar po aq. “Botimi i Buletinit të Njoftimeve Zyrtare” janë realizuar 16 nga 13 të planifikuara, dhe “Publikimi në Internet” janë realizuar 108 nga 124 të planifikuara.

## 3. Programi “Instituti i Mjeksisë Ligjore”

Ky program, për 4-mujorin e vitit 2016, ka realizuar treguesit e shpenzimeve në **masën 85 %**. Krahasuar me planin e periudhës, realizimi i zërave është si më poshtë:

• Shpenzimet e personelit	83 %
• Shpenzimet e tjera operative	99 %
• Shpenzimet kapitale	5 %
<b>Gjithsej</b>	<b>85 %</b>

Pra, siç shihet, realizimi i shpenzimeve të personelit dhe operative është në nivel të mirë, kjo tregon për një punë të mirë të personelit të institucionit, fondet e akorduara janë përdorur në mënyrë efikente duke përmbushur kështu objektivat e planifikuara.

Për 4-mujorin e vitit 2017, Instituti i Mjekësisë Ligjore ka planifikuar 9 produkte, Aktet e ekspertimit mjeko-ligjor (dokumenta çështje), Aktet Dëshmi-Ligjore, Aktet ekspertimi Toksikologjiko –Ligjor, Aktet ekspertimi Psikiatriko-Ligjor, Aktet ekspertimi Mjeko-Ligjor (autopsi), Aktet ekspertimi Biologjiko-Ligjor, Aktet ekspertimi Histopatologjiko-Ligjor, Shtim kati mbi morgun ekzistues dhe rikonstruksion si dhe Menaxhimi i punës në institut. Produktet në përgjithësi janë realizuar në masën 100%, por nga ato që e kanë kaluar realizimin mbi 100% dhe nga ato të cilat nuk janë realizuar 100 %. Kjo për vetë faktin që është e pamundur që të kemi një parashikim ekzakt, se sa akte do të bëhen, pasi nuk mund të parashikojmë me saktësi sa do të jetë dhuna në familje, apo aksidentet rrugore etj.

#### 4. Programi “Sistemi i Burgjeve”

Realizimi i shpenzimeve për 4-mujorin e vitit 2017 për këtë program, që përfaqëson rreth 46 % të totalit të buxhetit të Ministrisë së Drejtësisë, është realizuar në masën 75% sipas zërave kryesore krahasuar me planin e periudhës, rezulton si më poshtë:

• Shpenzimet e personelit	87 %
• Shpenzimet e tjera operative	64 %
• Shpenzimet kapitale	2.5 %
<b>Gjithsej</b>	<b>75%</b>

Duke iu referuar shifrave, shihet se realizimi i treguesve financiarë për periudhën është optimal, në shpenzimet operative realizimi mjaftueshëm dhe në shpenzimet e personelit kanë patur një performancë të mirë. Treguesit janë realizuar optimalisht në terma sasiorë ashtu edhe në terma financiarë.

Për 4-mujorin e vitit 2017 janë parashikuar 22 produkte për aktivitetin kryesor të burgjeve, “Trajtimi me normë ushqimore i të dënuarve dhe paraburgosurve”, “Staf i trainuar nga qendra e trainimit” “Mbajtja e të burgosurve dhe paraburgosurve në kushte sigurie nga trupa policore”, “Drejtimi dhe zhvillimi normal i aktivitetit për mirfunksionimin e përgjithshëm të sistemit të burgjeve”, “Realizimi i detyrave funksionale nga stafi shëndetsor dhe edukimi” dhe “Blerje Pajisje Mjete transporti per Sistemin e Burgjeve”. Këto produkte janë realizuar në nivel të mirë dhe kjo tregon për një punë të mirë në drejtim të realizimit të objektivave të Institucionit. “Trajtimi me normë ushqimore i të dënuarve dhe paraburgosurve”, është planifikuar 5830 dhe është realizuar 5830, “Staf i trainuar nga qendra e trainimit” është planifikuar 250 dhe është realizuar 250, “Mbajtja e të burgosurve dhe paraburgosurve në kushte sigurie nga trupa policore”, “Drejtimi dhe zhvillimi normal i aktivitetit për mirfunksionimin e përgjithshëm të sistemit të burgjeve”, “Realizimi i detyrave funksionale nga stafi shëndetsor dhe edukimi” janë realizuar plotësisht.

## 5. Programi “Shërbimi i Përmbartimit Gjyqësor”

Realizimi i shpenzimeve 4-mujorin e vitit 2017, krahasuar me buxhetin e akorduar të periudhës, është në **masën 54%**. Realizimi i shpenzimeve sipas zërave kryesorë, rezulton si më poshtë:

• Shpenzimet e personelit	65%
• Shpenzimet e tjera operative	59%
• Shpenzimet kapitale	0%
<b>Gjithsej</b>	<b>54%</b>

Treguesit buxhetorë tregojnë për një realizim të mirë të shpenzimeve të personelit, shpenzimeve operative dhe shpenzimeve kapitale.

Për 4-mujorin e vitit 2017, produkti i parë *“Ekzekutimi i titujve ekzekutivë”*, është realizuar pjesërisht janë ekzekutuar 2,386 tituj ekzekutivë, nga 12,884 të planifikuara për vitin 2017, mosrealizimi. Produkti i dytë *“Menaxhimi i Shërbimit Përmbartimor Gjyqësor”*, është realizuar plotësisht sipas parashikimit. Produkti i tretë *“Kosto Lokale për ndërmjetësim, përmbartim SPEZH”*, është realizuar plotësisht, cdo kërkesë e ardhur nga Ministria e Drejtësisë, për plotësimin e kërkesave projektit të binjakëzimit të BE-së, Nr.AL/12/IB/JH/02 “Përmirësimi i Sistemit Përmbartimor në Shqipëri”, realizimi i këtij zëri është në masën 1,591 në mijë lekë.

## 6. Programi “Shërbimi për Çështjet e Birësimeve”

Ky program, për 4-mujorin e vitit 2017, ka realizuar treguesit e shpenzimeve në **masën 52%**. Krahasuar me planin e periudhës, shpenzimet janë realizuar në zëra si më poshtë:

• Shpenzimet e personelit	70 %
• Shpenzimet e tjera operative	30 %
• Shpenzimet kapitale	0 %
<b>Gjithsej</b>	<b>52 %</b>

Realizimi i shpenzimeve të personelit është në nivele optimale dhe shpenzimeve operative është në nivele të ulët pasi është 4-mujorshi i parë i vitit.

Sa i takon buxhetin të miratuar për vitin 2017, planin për periudhën Janar-Prill 2017 si dhe realizimit faktik të fondeve gjatë periudhës raportuese, ju paraqesim relacionin sipas artikujve përkatës për Institucionin tonë si në vijim:

- Artikulli 600 (Pagat)

Shpenzimet e planifikuara për këtë artikull gjatë periudhës 4/mujore Janar-Prill 2017 janë 2.590.000 lekë, kurse realizimi i tyre është në masën 1.981.436 lekë. Fondet për këtë artikull janë realizuar 76,5%. Diferenca në realizim vjen si pasojë e një pozicioni pune vakant në strukturën e Institucionit tonë.

- Artikulli 601 (Sigurime shoqërore dhe shëndetësore)

Për periudhën raportuese Janar-Prill 2017, plani i shpenzimeve është 510.000 lekë, nga të cilat janë realizuar 327.856 lekë. Për këtë artikull kemi një realizim të fondeve në masën 64,3%. Edhe në këtë rast, përqindja e realizimit të fondeve nuk është e plotë për shkak të pozicionit vakant në strukturë, gjë që sjell ulje të shpenzimeve faktike për këtë artikull.

- Artikulli 602 (Mallra dhe shërbime të tjera)

Gjatë periudhës Janar-Prill 2017, është parashikuar shpenzim në masën 2.420.000 lekë për këtë artikull, kurse realizimi faktik i fondeve është 689.266,9 lekë. Realizimi për këtë zë është në masën 28,5%. Në këtë rast, ka diferenca të mëdha duke qënë se, në vlerën e fondit të parashikuar për këtë artikull për periudhën raportuese është parashikuar shuma prej 800.000 lekë për blerjen e karburantit që do të përdoret për nevoja të Institucionit gjatë vitit si dhe fondi për disa procedura të tjera prokurimi të tilla si: blerje mjete kancelarike, letër, tonera për printer e fotokopje, shpenzime për mirëmbajtjen dhe siguracionin e mjeteve të transportit, të cilat nevojiten për zhvillimin normal të punës. Këto procedura prokurimi janë zhvilluar gjatë muajit Prill 2017 dhe pagesat përkatëse të tyre janë kryer në fillim të muajit Maj 2017. Gjithashtu një pjesë tjetër e procedurave të prokurimit janë në proces ose janë parashikuar të fillojnë gjatë muajve në vazhdim. Në përfundim të vitit buxhetor, parashikohet realizim i plotë i fondeve për këtë artikull.

- Artikulli 231 (Investime)

Planifikimi i fondeve për këtë zë, për periudhën 4/mujore Janar-Prill 2017, është 300.000 lekë (fond i ngrirë), i cili është parashikuar për prokurimin me objekt blerjen e pajisjeve elektronike. Detajimi i fondeve për këtë artikull është bërë me shkresën e Ministrisë së Financave nr. 395/2, datë 31.01.2017 “Dërgohet detajimi i investimeve për vitet 2017-2019”. Menjëherë pas detajimit të fondeve, Institucioni ka kërkuar miratimin nga AKSHI për blerjen e pajisjeve elektronike që nevojiten nëpërmjet shkresës nr. 60, datë 06.02.2017 “Kërkesë për miratimin e blerjes së pajisjeve elektronike” (Versioni 1.0) dhe shkresës nr.79, datë 23.02.2017 “Kërkesë për miratimin e blerjes së pajisjeve elektronike” (Versioni 2.0). Pas miratimit të këtij prokurimi nga AKSHI nëpërmjet shkresës nr. 621/1, datë 09.03.2017 u kërkuar miratimi për çngurtësimin e fondit nga Ministria e Financave, i cili u konfirmua me shkresën nr.4394/1, datë 11.04.2017. Procedura për prokurimin e pajisjeve elektronike të parashikuara ka filluar, dhe pagesa përkatëse do të kryhet gjatë muajit Maj 2017.



## 7. Programi “Agjensia e Trajtimit të Pronave”

Realizimi i shpenzimeve buxhetore për 4-mujorin e vitit 2017, krahasuar me buxhetin e akorduar të periudhës, është në **masën 95 %**. Realizimi i shpenzimeve, sipas zërave kryesorë, rezulton si më poshtë:

• Shpenzimet e personelit	70 %
• Shpenzimet e tjera operative	30 %
• Shpenzimet kapitale	0 %
<b>Gjithsej për shpenzimet buxhetore</b>	<b>95%</b>

Gjatë 4-mujorit të parë të vitit 2017, programi Shërbimet i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave ka parashikuar 6 produkte: “Shperndarja e Fondit Financiar ne dispozicion te subjekteve”, i cili është realizuar plotësisht, në masën 6500, produkti i dytë “Shperndarja e Fondit Financiar ne dispozicion te subjekteve .” është realizuar 142 nga 220 të planifikuara. “Trajtimi me vendim i kërkesave të subjekteve për kalimin në pronësi të oborreve në përdorim” janë realizuar 78 nga 220 të planifikuara. “Fondi Toke në dispozicion të subjekteve që trajtohen nga A T P” ku janë realizuar plotësisht në masën 247. “Ndjekja e proceseve gjyqësore të ATP” e cila është realizuar plotësisht në masën 258. “Trajtimi i kërkesave ndër vite për njohje pronësie” ku janë trajtuar 500 raste nga po aq të planifikuara.

## 8. Programi “Shërbimi i Provës”


Realizimi i shpenzimeve për 4-mujorin e parë të vitit 2017, krahasuar me buxhetin e periudhës, është në **masën 63%**. Realizimi i shpenzimeve, sipas zërave kryesorë, rezulton si më poshtë:

• Shpenzimet e personelit	71%
• Shpenzimet e tjera operative	76 %
• Shpenzimet kapitale	0%
<b>Gjithsej</b>	<b>63%</b>

Për 4-mujorin e parë të vitit 2017, Drejtoria e Shërbimit të Provës ka parashikuar 2 produkte: “Shërbime mbështetëse për riintegrimin social-ekonomik të fëmijëve në konflikt me ligjin pjesë e shërbimit të provës”, i cili është realizuar plotësisht, në masën 1800, po kështu edhe produkti i dytë “Integrimi I të miturve në konflikt me ligjin përmes Drejtësisë restitutive”, është realizuar plotësisht sipas planifikimit në masën 133.

Po ju paraqesim me poshtë në një grafik përmbledhës realizimin e fondeve të Ministrisë së Drejtësisë sipas programeve.

### Realizimi i fondeve Buxhetore sipas Programeve në mijëra lekë



Duke ju falënderuar për mirëkuptimin dhe bashkëpunimin.

**SEKRETARE E PËRGJITHSHME**

**JULIANA HOXHA**

**ANEKSI nr.1 "Raporti i Shpenzimeve sipas Programeve"**

ne 000/leke

Emri i Grupit	MINISTRIA E DREJTËSISE		Kodi i Grupit				
Shpenzimet e Ministrisë/Institucionit							
Titulli	(1) Fakti i vitit paraardhës Viti 2016	(2) PBA Plani Viti 2017	(3) Buxheti Vjetor Plan Fillestar Viti 2017	(4) Buxheti Vjetor Plan i Rishikuar Viti 2017	(5) Buxheti Vjetor Plani i Periudhes/progre siv	(6) Fakti i Periudhes/progre siv	(7)=(6)-(5) Diferenca
<b>Emertimi</b>							
01120	431,026	767,500	767,500	767,500	291,000	290,609	-391
Planifikim Menaxhimi Administrim							
	43,854	49,400	83,000	83,000	25,730	11,894	-13,836
Qendra Publikimeve Zyrtare							
	132,021	136,500	136,500	136,500	29,866	25,272	-4,594
Instituti Mjekesive Ligjore							
	4,231,155	4,958,000	5,007,800	5,007,800	1,895,469	1,414,668	-480,801
Sistemi Burgjeve							
	99,377.0	135,000.0	135,000.0	135,000.0	55,640.0	30,190.0	-25,450
Sherbimi Permbarrimit Gjyqesor							
	12,232.4	13,800.0	13,800.0	13,800.0	5,820.0	2,998.6	-2,821
Komiteti Shqiptar Biresimeve							
	3,696,730	2,079,500	2,079,500	2,079,500	1,298,200	1,244,209	-53,991
Sherbimi Kthimit e Kompesimit Pronave							
	176,200	181,000	181,000	181,000	60,333	37,752	-22,581
Sherbimi I Proves							
<b>Totali i Shpenzimeve te Ministrise</b>	<b>8,822,595</b>	<b>8,320,700</b>	<b>8,404,100</b>	<b>8,404,100</b>	<b>3,662,058</b>	<b>3,057,593</b>	<b>-604,465</b>
<b>Shpenzime nga te Ardhurat Jashte limitit</b>							
<b>Totali</b>	<b>8,822,595</b>	<b>8,320,700</b>	<b>8,404,100</b>	<b>8,404,100</b>	<b>3,662,058</b>	<b>3,057,593</b>	

Sekretari i Përgjithshëm	Emri	JULIANA HOXHA
	Firma	
	Data	

**ANEKSI nr.2 "Raporti i Shpenzimeve të Programit sipas Shpenzimeve"**

ne 000/leke

Emri i Grupit Programi	MINISTRIA E DREJTËSISE Planifikim Administrativ Menaxhim							Kodi i Grupit	14
	Art.	Emertimi	(1) Fakti i vitit paraardhes Viti 2016	(2) PBA Plan 2017	(3) Buxheti Vjetor Plan Fillestar Viti 2017	(4) Buxheti Vjetor Plan i Rishikuar Viti 2017	(5) Buxheti Vjetor Plani i Periudhes/progressiv	(6) Fakti i Periudhes/progressiv	(7)=(6)-(5) Diferenca
600	Paga		201,080	272,000	272,000	272,000	89,000	69,647	-19,353.0
601	Sigurime Shoqërore		31,553	52,000	52,000	52,000	16,733	10,962	-5,771.0
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera		158,667	137,410	137,410	137,410	59,769	41,002	-18,767.0
603	Subvencione								0.0
604	Transferta Korente të Brendshme								0.0
605	Transferta Korente të Huaja		6,157	12,230	12,230	12,230	2,836	2,836	0.0
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ		970	360	360	1,038	1,038	1,038	0.0
<b>Non-Totali</b>	<b>Shpenzime Korrente</b>		<b>398,427.0</b>	<b>474,000.0</b>	<b>474,000.0</b>	<b>474,678.0</b>	<b>169,376.0</b>	<b>125,465.0</b>	<b>-43,891.0</b>
230	Kapitale të Patrupezuara								
231	Kapitale të Trupëzuara		56,800	293,500	293,500	293,500	202,333	164,124	
232	Transferta Kapitale								
<b>Non -Totali</b>	<b>Shpenzime Kapitale me financim te brendshem</b>								
230	Kapitale të Patrupezuara								
231	Kapitale të Trupëzuara								
232	Transferta Kapitale								
<b>Non-Totali</b>	<b>Shpenzime Kapitale me financim te huaj</b>								
<b>Totali</b>	<b>Shpenzime Kapitale</b>		<b>0.0</b>	<b>0.0</b>	<b>0.0</b>	<b>0.0</b>	<b>0.0</b>	<b>0.0</b>	<b>0.0</b>
<b>Totali</b>	<b>Shpenzime nga Të ardhurat jashte limiti</b>								
<b>Totali (korrente + kapitale + Shp nga te ardh.jashte limiti)</b>			<b>455,227.0</b>	<b>767,500.0</b>	<b>767,500.0</b>	<b>768,178.0</b>	<b>371,709.0</b>	<b>289,609.0</b>	<b>-43,891.0</b>

Drejtesuesi i Ekipit Menaxhues të Programit	Emri : PETRIT BAKID	Sekretari i Përgjithshëm	Emri	JULIANA HOXHA
	Firma		Firma	
	Data		Data	

**ANEKSI nr.3 "Raporti përmblledhës i realizimit të tregësive të performances/produkteve të programit"**

Emri i Grupit	MINISTRIA E DREJTËSISE	Kodi i Grupit	14
Programi	Planifikim, Menaxhimi dhe Administrimi	Kodi i Programit	01110

Kodi	ne 000/leke	Njësia matëse	Sasia Faktike (sipas vitit paraardhës)	Shpenzimet (sipas vitit paraardhës)	Kosto per Njesi (sipas vitit paraardhës)	I		II		III		IV		Komente
						Sasia (sipas planit të vitit korent)	Shpenzimet (sipas planit të vitit korent)	Kosto per Njesi (sipas planit të vitit korent)	Sasia (sipas planit të vitit korent)	Shpenzimet (sipas planit të vitit korent)	Kosto per Njesi (sipas planit të vitit korent)	Sasia Faktike (ne fund te vitit korent)	Shpenzimet Faktike (ne fund te vitit korent)	
A	Akte Ligjore dhe nenligjore te pergatitura	nr. Aktesh	5			5								
B	Inspektime te kryera ne gjyqesor, prokurori, institucionet vartese dhe pronesi	nr. Inspektimesh	28			28								
C	Dhenia e ndihmes Juridike Paresore dhe Dytësore	Numri total i i ndihmes Juridike	570	14,824	26	660	9,532	44	660	9,532	44	217	9,532	44
D	Licensimi i Administratoreve te Falimentit	Nr i rasteve te mbikeqyrtjes	0	0	0	5	0	0	5	0	0			
E	Mbikenyja e Administratoreve te Falimentit	Licensuarave	17	50	3	30	100	3	30	100	3	0	0	
F	Asistenc juridike Institucioneve Shtetore dhe Eneve Publike nepermjet keshillimit dhe perfaqesimit ne Gjykatat e Kombetare e Niderkombetare	numër	12,040	111,112	9	12,000	153,500	13	13		9	4,202	0	0
G	Sistem i mbikeqyrtjes elektronike i mrimëbajtur dhe zgjeruar	nr. sistemesh	1	1										
H	Sisteme te zhvilluar dhe te permissuar (ICMIS ALBIS RNSH)	nr. sistemesh	1	1										
J	Ndertimi i databazes qendrore per bashkepunimin ndërgjyqësor me jashte	Nr sistemi	1	1										

**Tregësit e Performances/Produktet e realizuara nga perdorimi i te ardhurave jashte limitit**

Kodi	Emertimi i Tregësit të Performances/Produktit	Njësia Matëse	Sasia e realizuar	Fakti i periudhes/progresiv	Komente
A	Produkti .....			0.0	
D	Tregësi i Performances .....			0.0	

Drejtuesi i Ekspit Menaxhues të Programit	Emri	PETRI BAKIU	Emri	JULIANA HODKA
	Firma		Firma	
	Data		Data	

**ANEKSI nr.4 "Raporti i realizimit te objektivave te politikave te programit"**

Periudha e Raportimit: VITI 2016

Kodi i Programit	Emertimi i programit:	10140001	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	Komentet		
**Treguesit e performancës/Produktet:						
	Kodi i Treguesit e Performancës/Produktit	Emertimi i Treguesit e Performancës**/Produktit	Niveli i faktit i vitit paraardhes	Niveli i planifikuar ne vitin korrent	Niveli faktik ne fund te vitit korrent	% e Realizimit te Treguesit te Performances/Produktit
Qelimi 1		Harmonizimi dhe reformimi i legjislacionit shqiptar, si edhe perqasja e legjislacionit ne standartet e BE. Përmirësimi i shërbimeve të nevojshme që lidhen me sistemin gjyqësor dhe penitenciar si dhe përmirësimi i shërbimeve në institucionet vartëse, sipas standartëve të BE. Shëndërimi i Avokatueses së Shtetit në një institucion të specializuar dhe etikas për mbrojtjen e interesave civile pasurore, jopasurore, ligjore të shtetit shqiptar. Përmirësimi i performancës së KSHNJ, rritja e efektivitetit të ndihmës juridike, në mbrojtje të të drejtave dhe lirive themelore të individit, interesave të ligjshme në gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe interesat e grupeve vulnerabël. Përmirësimi i performancës së AMF duke u bërë i vetmi burim informacioni mbi të gjitha procedurat e procesit të falimentit, në territorin e Republikës, në abazim të akteve ligjore në fuqi dhe interesave të ligjshme të palëve të përfshira në këto procedura.				
		*Objektivat e politikës*:				
Objektivi 1.1		Menaxhimi i Aparatit të Ministrisë, nëpërmjet menaxhimit të lartë, shërbimeve financiare , menaxhimit të burimeve njerëzore, auditimit të brendshëm dhe sigurimit të shërbimeve të përgjishme të stafit të ministrisë.	B			#DIV/0!
Objektivi 1.2		Përmirësimi i procesit të hartimit të legjislacionit, përgatitja e rreth 50 projekt ligjesh dhe projektvendimeve në fushën e përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Drejtësisë dhe dhenia e mendimit të specializuar mbi projektaktet e tjera normative të Këshillit të Ministrave, të ministrive dhe institucioneve qëndrore.	A			#DIV/0!
Objektivi 1.3		Rritja e efektivitetit dhe bashkërendimit me organet e pushtetave të tjera, nëpërmjet 37 inspektive tematike në gjykatat e shkalles se pare dhe te Apelit dhe 8 kontroleve dhe inspektive tematike ne organin e Prokurorisë.	D			#DIV/0!
Objektivi 1.4		Forcimi i sistemit të drejtave të promesise dhe mbrojtjes se tyre, mblidhja dhe monitorimi i veprimtarise se AKXP, si edhe përmirësimi i organizimit të funksionimit të tyre, nëpërmjet 37 inspektive të kryera dhe marrjes së masave konkrete në raste të shkeljes se ligjit.				
Objektivi 1.5		Rritje e shërbimit keshillimor per veprimtarine juridike te organeve te administrates shtetërore dhe perfaqesim per mbrojtjen e interesave te shtetit shqiptar, prane gjykatave kombetare dhe nderkombetare, ne 100 % te ceshjeve gjyqësore dhe keshillime.				
Objektivi 1.6		Përmirësimi i performancës së Agjencisë së Mblidhëtrjes së Falimentit nëpërmjet trajnimit paraprak e organizimit të provimit mbi procedurat e licensimit të 5 administratorëve të të rinj të falimentit.				
Objektivi 1.7		Ofrimi i shërbimeve të keshillimit, përfaqësimit dhe mbrojtjes në proceset gjyqësore penale, në rreth 300 procese gjyqësore civile dhe administrative, nga Komisioni Shtetëror i Ndihmës Juridike, implementimi i një projekti pilot në funksion të zgjerimit të veprimtarisë së Komisionit Shtetëror të Ndihmës Juridike nëpërmjet hapjes së zyrave lokale në 6 (gjashtë) qarqe: Durrës, Elbasan, Shkodër, Kukës, Korçë, Elër.				
Objektivi 1.8		Rritja e transparencës nëpërmjet publikimit të datave dhe seanceve të gjykatave, rritja e transparencës nëpërmjet regjistrimit të akteve të realizuara nga noteret.	C			#DIV/0!

\*Objektivat e listuar janë në funksion të përbushjes së qelimit të mesipër të politikës. Nëse specifikohet me shume se 1. Qelimi, at se bashku me objektivat e tij (psh Qelimi 2 me Objektivi 2.1; 2.2; etj) duhet te futen ne nje tabelë tjetër te ngjashme, ne vazhdim te kesaj.

\*\* Si tregues për vlerësimin e performancës së objektivave, krahas produkteve, shërbimeve edhe tregues të tjerë të matshëm të lidhur me to. Këtu mund të jenë standartet të njohura të fushës; tregues statistikorë; indekse kombëtare e ndërkombëtare, etj.

\*\*\*Këtu listohen të gjithë treguesit e performancës, përfshi dhe produktet. Raportimi per produktet behet periodik dhe vjetor, ndersa raportimi per treguesit e performances mund te behet edhe vetem vjetor, nqs matshmeria e tyre periodike paraqet veshtiresi objektive.

Nivelloshihet, per ata tregues performante te cilët nuk vlerësohen mbi baze vjetore (psh vlerësimet ndërkombetare të tilla si: OBI, PISA score, ete), si nivel i vitit paraardhes vendoset niveli me i fundit i regjistruar per ta.

**ANEKSI nr.5 "Projektet e investimeve me financim te brendshem dhe me financim te huaj"**

Projektet me financim te brendshem (ne 000/leke)

Kodi projektit	Emertimi i projektit	Vlera e plotë e projektit	Viti i fillimit të projektit	Viti i përfundimit të projektit	Buxheti 2016 Kontraktuar	Plani i buxhetit viti 2017	REALIZIMI PROGRESIV nga fillimi i vitit deri në periudhën aktuale	REALIZIMI për periudhën e raportimit (4 mujore/vjetrore)	REALIZIMI PROGRESIV nga fillimi i vitit deri në periudhën aktuale	Komente
	Mirembajtje dhe zhvillimi i sistemit ICMS (kontrata ne vazhdim)	22,300	2010	Vazhdim		22,300	8,820	8,820	8,820	
	Blerje pajise elektronike	3,000	2017	2017		2,996	-	-	-	
	TVSH- Misioni Eurallius	9,200	2010	Vazhdim		9,200	-	-	-	
	Kosto lokale ndermjetesimi	2,000	2015	Vazhdim		2,000	-	-	-	
	Rikonstrukcion pjesor i godines se Ministrise se Drejtesise	30,000	2016	2017		30,000	-	-	-	
	Dixhitalizimi i regjistrimit te noterise dhe lidhja online me Sherbimin e Regjistrimit te Pasunise (kontrate 24 muaj ne vazhdim)	8,000	2010	Vazhdim		8,000	864	864	864	
	Zhvillimi dhe permesimi i ALBIS	68,000	2015	2020		15,000	4,440	4,440	4,440	
	Krijimi i nje sistemi elektronik per dixhitalizimin e Arkives Gjyqesore	20,000	2017	Vazhdim		20,000	-	-	-	
	Përmirësimi i një sistemi elektronik të avancuar për mbikqyrjen elektronike në fushën penale	234,000	2017	2020		150,000	150,000	150,000	150,000	
	Mirembajtje i databazes qendror per bashkepunim nderqyqesor me jashte (kontrate ne vazhdim)	504	2015	Vazhdim		504	-	-	-	
	Sistemi elektronik per menaxhimin e sigurimin e funksionalitetit dhe implementimi i 'high availability' per infrastrukturen qendrore te sistemeve IT ne Ministrine e Drejtesise.	21,000	2017			21,000	-	-	-	
	<b>TOTALI</b>	<b>293,500</b>				<b>293500</b>	<b>164,124</b>	<b>164,124</b>	<b>164,124</b>	

Projektet me financim te huaj (ne 000/leke)

Kodi projektit	Emertimi i projektit	Grant/ Kredi	Vlera e plotë e projektit	Viti i fillimit të projektit	Viti i përfundimit të projektit	Buxheti Kontraktuar	Plani i buxhetit viti	REALIZIMI për periudhën e raportimit (4 mujore/vjetrore)	REALIZIMI PROGRESIV nga fillimi i vitit deri në periudhën aktuale	REALIZIMI PROGRESIV nga fillimi i vitit deri në periudhën aktuale	Komente

Drejtesi i Ekipit Menaxhues të Programit	Emri	PETRI BAKIU	Emri	JULIANA HOJHA
	Firma		Firma	
	Data		Data	